



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 96/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Conex Group” Sh.p.k me numër te biznesit 70464055, me seli në Gurakoc, Komuna e Istogut, të cilin e përfaqëson pronari D.F., kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit përfundimtar të PSH.nr.728/18 të datës 13.12.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 06.09.2023, në mungesë të përfaqësuesit të paditësit dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditurës Erëlehta P., me datë 25.09.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadija e paditësit “Conex Group” Sh.p.k me numër te biznesit 70464055, me seli në Gurakoc, Komuna e Istogut, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë.
- II. **ANULOHET** Vendimi me shifrën PSH.nr.728/18 i datës 13.12.2018, i nxjerre nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, si i pabazuar dhe çështja i kthehet të paditurës në rivlerësim dhe rivendosje.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 13.11.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative “Conex Group” Sh.p.k me numër te biznesit 70464055, me seli në Gurakoc, Komuna e Istogut, të cilin e përfaqëson pronari D.F., ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.120/19 kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit përfundimtar PSH.nr.728/18 të datës 13.12.2018, me propozim që Gjykata aprovoj padinë si të bazuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr.96/22.
3. Seanca përgatitore në këtë çështje administrative u mbajt më datë 07.08.2023. Me datë 06.09.2023 gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik në mungesë të

përfaqësuesit të paditësit konfrom nenit 41 të LKA-së, për shkak se i njëjti ishte i njoftuar me anë të procesverbalit të datës 07.08.2023 të cilin e ka pranuar me datë 16.08.2023 dhe mungesën nuk e ka aryetuar me pjesëmarrje të përfaqësueses Erëlehta P. për të paditurin me autorizim të datës 21.07.2023.

Pretendimet e paditës

4. Përfaqësuesi i paditësit D.F. në pretendimet e dhëna në padi, ka kërkuar nga gjykata që të aprovet padia e paditësit “Conex Group” SH.P.K me seli në Prishtinë në adresën Major M.B., me certifikatë të nr.fiskal: 600036786 me pronarë D.F., nga fshati Gurakoc, Komuna e Istogut si e bazuar dhe të anulohet vendimi i OSHP-së me nr. PSH.nr.728/18 të datës 13.12.2018, me të cilin operatori ekonomik “Conex Group” SH.P.K është eliminuar në mënyrë të padrejtë me arsyetim se është i papërshtatshëm profesionalisht pa dhënë asnjë arsyetim. Me ç’rast ankesa ankësa e “Conex Group” SH.P.K është refuzuar si palë pa interes, njoftimi për dhënie të kontratës të Ministrisë së Infrastrukturës me numër të prokurimit 17-071-211 Peja 2 ku ka shpallur fitues operatori ekonomik Granit SH.P.K me seli në Istog, është aprovuar duke shkaktuar dëme operatorit ekonomik “Conex Group” SH.P.K për çka konsideron se është i pabazuar vendimi dhe i njëjti duhet të anulohet, po ashtu ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale.
5. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 06.09.2023 për paditësin u lexuan pretendimet e padisë.

Kundërshtimet e të paditurës

6. Përfaqësuesja e të paditurës zyrtarja P. në kundërshtimet e paraqitura në përgjigje në padi, në deklaratimet e dhëna gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë vendimit të paneli shqyrtues të atakuar me padi duke konsideruar se Operatori Ekonomik paditës është konsideruara i pa përshtatshëm sipas nenit 65 par 3 pika 4 e LPP-së për shkak të vendimit të gjykatës themelore në Prishtinë të datës 03.03.2016 me të cilin Operatori Ekonomik më saktësisht menaxheri i kompanisë është shpallur fajtor për mashtrim sipas aktgjykimit të kësaj gjykate (VF) andaj duke qenë se sipas nenit të lartë cekur një pronar ose menaxher nëse shpallet fajton për veprën penale mashtrimit deklarimit të rrem nuk mund të merr pjesë në një procedurë të prokurimit sepse është i pa përshtatshëm profesionalisht për këtë arsye paneli i OSHP-së pale pa interes juridik material ashtu siç ishte para në nenin 4 par 1.26 i LPP-së lidhur me nenin 111 par 1-8 i LPP-ë për këtë arsye i është hedhur poshtë ankesa si e pa lejuar andaj të gjitha këto prova dhe fakte konsiderojmë se padi e paditësit është e pa bazuar a ndaj i propozojmë gjykatës që pas vlerësimit dhe administrimit të provave në shkresat e lëndët, aktgjykimit të gjykatës themelore, padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Provat e administruara

7. Certifikata e regjistrimit të biznesit Conex Group SJ.P.K. me nr të regjistrimit të biznesit 70464055, Certifikatë me nr. AGJ4747/18 e datës 04.09.2018 nga gjykata

themelore në Prishtinë departamenti për çështje ekonomike, Certifikatë nga evidenca penale nga Gjykata Themelore në Pejë për D.F. e datës 10.09.2018 me nr 2596/2018, Certifikatë nga evidenca penale nga Gjykata Themelore në Pejë për E.F.S. e datës me nr.2595/2018 e datës 10.09.2018, Vendimi i kundërshtuar me nr. PSH.728/18 i datë 13.10.2018, Raporti i ekspertit me lëndën nr. 131-132-138-140-143 -148/2018, me titull të aktiviteti “ mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale 2017, 2018 2019”,Vendim i Panelit Shqyrtues me nr PSH.131-132-138-140-143-148/18 me datë 15.05.2018, Raporti i ekspertit me nr.337-343-349-354-357/2019, Njoftimi për nënshkrimin e kontratës 17.12.2018, Vendim mbi refuzimin e ankesës të parashtruar nga OE Conex Group e datës 03.12.2018 në Ministrinë e Infrastrukturës, Letër standarde për tenderuesin e eliminuar e datës 23.11.2018, për OE Conex Group dhe Elbau, Njoftimi për kontratë i datë 29.09.2017, Njoftimi për dhënie të kontratës për të njëjtit aktivitet të prokurimit të datës 13.09.2018, Vendim nga OSHP me nr PSH.337-343-349-354-357/2018 i datës 30.08.2018, Njoftim për dhënie të kontratës i datës 03.07.2018, Kërkesa për rishqyrtim nga paditësi Conex Group e datës 02.07.2018, Njoftim për informata shtesë, Njoftim për dhënie të kontratës 26.03.2018, Ankesë nga OE Conex Group e datës 12.12.2018, Procesverbal i hapjes së tenderit.

8. Nga Certifikata e regjistrimit të biznesit Conex Group SH.P.K. me nr. të regjistrimit të biznesit 70464055, me datë të regjistrimit 19.12.2007, konstatohet se operatori ekonomik Conex Group është regjistruar si Sh.p.k me datë 19.12.2007, me veprimtari primare ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore, me pronar D.F. dhe E.F.S..
9. Nga Certifikatë me nr. AGJ.nr.4747/18 e datës 04.09.2018 nga Gjykata Themelore në Prishtinë departamenti për çështje ekonomike është konfirmuar që operatori ekonomik “Conex Group” Sh.p.k nuk është shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara dhe ndaj të njëjtit nuk është e iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht likuidimit.
10. Nga Certifikatë nga evidenca penale nga Gjykata Themelore në Pejë për D.F. e datës 10.09.2018 me nr 2596/2018 është konfirmuar që ndaj personit D.F. nuk është duke u zhvilluar procedurë penale si dhe nuk është i dënuar.
11. Nga Certifikatë nga evidenca penale nga Gjykata Themelore në Pejë për E.F.S. e datës me nr.2595/2018 e datës 10.09.2018, është konfirmuar që ndaj personit E.F.S. nuk është duke u zhvilluar procedurë penale si dhe nuk është e dënuar.
12. Nga vendimi i kundërshtuar me nr. PSH.728/18 i datë 13.12.2018 është hedhur poshtë si e pa lejuar ankesa e operatorit ekonomik “Conex Group” sh.p.k – Prishtinës. kundër eliminimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Mirëmbajtje verore dhe Dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019” me numër prokurimit: 17-071-211 Lot Peja 2, iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës, operatorit ekonomik “Conex Group” sh.p.k është i papërshtatshëm profesionalisht, me arsyetim për shkak të shkeljeve të rënda profesionale, sipas nenit 65 paragrafi 3 pika 4 e LPP-së. Thuhet se ne rastin konkret kemi aktgjykim dënues të

Gjykatës Themelore në Prishtinë për pronarin e biznesit “Conex Group” sh.p.k . të shpallur fajtor për veprën falsifikim, mashtrim dhe deklarim i rremë nën betim, fakt ky i konstatuar me vendimin nr. 518/18, 528/18, 531/18 të datës 23.10.2018. Për këtë arsye OE është vlerësuar si palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së.

13. Nga vendim i Panelit Shqyrtues me nr PSH.131-132-138-140-143-148/18 me datë 15.05.2018 është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik ‘PP Janes’, operatori ekonomik “Via Egnatia & Milenium Kons.&Zhubi, operatori ekonomik “Jos&Krasniqi&Bazë”sh.p.k, operatori ekonomik “Alfa.I & Vllaznia Ndertimi I.S & Urban & Bageri” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Mirëmbajtje verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019” me numër prokurimit: 17-071-211, për Lotet Rajonale: Prishtina 2, Mitrovica 1, Mitrovica 2, Gjakova 1, Peja 2, Gjlani 2, Ferizaj1, iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës, sipas këtij vendimi aprovohet pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve të tjerë ekonomik lidhur me të njëjtin aktivitet të prokurimit.
14. Nga procesverbal i hapjes së tenderit i datës 26.01.2018, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Mirëmbajtje verore dhe Dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019” me numër prokurimit: 17-071-211, iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës, konstatohet se operatorit “Conex Group” sh.p.k. renditet i pari.
15. Nga njoftim për dhënie të kontratës i datës 23.11.2018 konstatohet se AK shpërblen me kontrate, OE “Graniti” i renditur ne liste pas operatorit “Conex Group” sh.p.k.
16. Letër standarde për tenderuesin e eliminuar e datës 23.11.2018, për OE Conex Group dhe Elbau, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtje verore dhe Dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019” me numër prokurimit: 17-071-211, iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës. duke konstatuar se janë operator të pa përshtatshëm.
17. Njoftimi për nënshkrimin e kontratës me numër të prokurimit 205-17-4559-2-1-1 i datës 17.12.2018 me OE te rekomanduar fitues.
18. Vendimi i datës 03.12.2018 në Ministrinë e Infrastrukturës mbi refuzimin e ankesës të parashtruar nga OE Conex Group për projektin “ Mirëmbajtje verore dhe Dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019” me nr.prokurimit 201-17-4559-2-1-1, i datës 27.11.2018 si të pashqyrtuar.

Vlerësimi i gjykatës

19. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, kundërshtimeve sipas përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe në bazë

të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

20. Gjykata vlerësoj se nga e paditura, me Vendim PSH.728/18 i datë 13.12.2018 nga e paditura, është hedhur poshtë si e pa lejuar ankesa e operatorit ekonomik “Conex Group” sh.p.k – Prishtinës kundër eliminimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Mirëmbajtje verore dhe Dimërore e rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës 2017-2018-2019” me numër prokurimit: 17-071-211 Lot Peja 2, iniciuar nga autoriteti kontraktues Ministria e Infrastrukturës, operatorit ekonomik “Conex Group” sh.p.k me arsyetim se është OE është i papërshtatshëm profesionalisht për shkak të shkeljeve të rënda profesionale, sipas nenit 65 paragrafi 3 pika 4 e LPP-së. Sipas konstatimit në vendim thuhet se ne rastin konkret kemi aktgjykim dënues nga Gjykata Themelore në Prishtinë për personin me inicialet V.F. pronarin e biznesit “Conex Group” sh.p.k . të shpallur fajtor për veprën falsifikim, mashtrim dhe deklarim i rremë nën betim, fakt ky i konstatuar me vendimin nr. 518/18, 528/18, 531/18 të datës 23.10.2018. Për këtë arsye OE është vlerësuar si palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1-8 i LPP-së.
21. Gjykata vlerëson se shkakun kryesor dhe i vetëm i eliminimit të paditësit “Conex Group” sh.p.k nga aktiviteti i prokurimit sipas Vendimit PSH.728/18 i datë 13.12.2018 është i pabazuar sepse nuk është vërtetuar me asnjë provë. Së pari nuk është vërtetuar identiteti i personit të dënuar ku në vendim e paditura i referohet me personit me inicialet V.F., e që nuk përputhet me inicialet e asnjërit pronar ku sipas certifikatës së biznesit me nr. 70464055, me datë të regjistrimit 19.12.2007 pronarë të biznesit Conex Group SH.P.K. janë: D.F. dhe E.F.S.. E paditura nuk e ka arsyetuar vendimit se çfarë cilësie apo pozite ka personi me iniciale V.F Conex Group SH.P.K. ne operatorin ekonomik të eliminuar, dhe as nuk e ka bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës të cilit i referohet me numrat 518/18, 528/18, 531/18 të datës 23.10.2018. Për ta vërtetuar këtë fakt gjykata ka verifikuar të dhënat e personave të dënuar dhe për personin D.F. nuk është vërtetuar se i njëjti është i dënuar për ndonjë vepër penale.
22. Gjykata konstaton se akti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Andaj me aprovoj padinë dhe anulojë aktin e kontestuar administrativ.
23. Në rivlerësim e paditura duhet ta vërtetoj shkakun kryesor të mbështetur në prova për të cilin paditësi është eliminuar, çfarë pozite mban personi me iniciale V.F Conex Group SH.P.K. sepse kemi të bëjmë me inicialet që nuk përputhen me inicialet e pronareve, e që është në kundërshtim me arsyetimin e vendimit të kundërshtuar.
24. Gjykata shqyrtoj edhe provat e tjera të administruara por vlerësoj se nuk janë me ndikim për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur shpenzimet procedurale u vendos në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.96/22, datë 25.09.2023

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.